



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË FIER.

Nr. 47/prot
11

Fier, më 08.05.2019

NJOFTIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURES SË KONKURIMIT PËR EMËRIMIN
NË POZICIONIN E PUNËS SEKRETAR**

Bazuar në ligjin nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë", si dhe urdhërit nr 27 date 21.02.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm për "Strukturën organike të Prokurorisë Prane Gjykatës së Shkallës se Parë Fier", me qëllimin plotësimin e vendeve vakante që ekzistojne në strukturën e institucionit në pozicionin sekretar, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier:

NJOFTON

1. Fillimin e procedurës për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin sekretar, pranë Prokurorëve në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

2. Referuar neneve 74, 75 dhe 76 të ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë", kandidatët e interesuar për konkurim, përvec kushteve të përgjithshme për t'u pranuar në shërbimin civil, duhet të plotësojnë dhe kriteret e vecanta, të jenë diplomuar ne drejtësi si dhe të ketë të paktën një vit praktikë profesionale ose cdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me Prokurorinë,

Kandidatët për pozicionin e lirë të punës "sekretar" duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Kërkesë me shkrim,
- b. Kopje të dokumentit të identifikimit,
- c. Curriculum Vitae,
- d. Diplomë universitare të nivelit "Bachelor" dhe "Master" ne Fakultetin Juridik (të noterizuara).
- e. Dokument që vërteton praktikën profesionale.
- f. Dëshmi kompjuteri.
- g. Dëshmi kualifikimi apo specializimesh (nëse ka),
- h. Vleresime të punës nga punëdhënësi të mëparshëm,
- i. Vërtetim për gjëndjen gjyqësore,
- j. Raport mjeko-ligjor,
- k. Certifikatë te gjuhës së huaj (nëse ka).

3. Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet brenda datës 22.05.2019 në Kryesekretarinë e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË FIER.**